



Garancia e të Rinjve në Ballkanin Perëndimor



RegionalCooperationCouncil



This project is funded
by the European Union

Kjo broshurë synon të shpjegojë Garancinë e të Rinjve në BE dhe siguron rekomandime për prezantimin e saj dhe zgjerimin në Ballkanin Perëndimor.

Garancia e të Rinjve në BE

Garancia e të Rinjve në vendet Europiane është lançuar nga Komisioni Europian në 2013 dhe përforcuar në 2020 si një angazhim politik i të gjitha Shteteve anëtare të BE për t'ju dhënë të gjithë të rinjve nën moshën 30 vjeç një ofertë me cilësi të mirë:

- ▷ Punësimi
- ▷ arsimi të vazhdueshëm
- ▷ një praktikë mësimore ose
- ▷ një praktikë profesionale

Brenda 4 muajve nga përfundimi i arsimit formal ose nga përfundimi i punësimit.


Maqedonia e Veriut është vendi i parë nga Ballkani Perëndimor që ka prezantuar një formë të Garancisë së të Rinjve në 2018. Kështu, ka patur një reduktim prej 8.9% sa i takon papunësisë afatgjatë të të rinjve ndërmjet vitit 2017 dhe 2019.



Garancia e të Rinjve në BE-Histori Suksesi

Rreth shtatë vite më parë, pak para pandemisë COVID-19, kishte rreth 1.7 milion më pak të rinj në punë, ose në proces studimi ose trajnimi (NEETs) në të gjithë BE-në. PAPUNËSIA e të rinjve pësoi RËNIE në një NIVEL TË ULËT prej 14.9% në Shkurt të 2020, përpara se të aplikoheshin izolimet të lidhura me pandeminë në të gjithë BE.

Megjithëse një kontekst i përmirësuar makro-ekonomik sigurisht që luajti rol, të dhënat tregojnë që Garancia e të Rinjve, ka patur një efekt të madh transformues. Mbi 24 milion të rinj që një herë ishin rregjistruar në skemat e Garancisë së të Rinjve morën një ofertë punësimi, studimi, praktike ose trajnimi.¹



Garancia e të Rinjve në Bashkimin Europian

Garancia e të Rinjve në BE u krijua përmes Rekomandimit të Këshillit më 22 Prill 2013 dhe që nga ajo kohë ka marrë mbështetje të fortë politike. Këshilli Europian miratoi Garancinë e të Rinjve gjatë samitit të Qershorit të vitit 2013 në përgjigje të krizës ekonomike, duke kërkuar më pas vazhdimin e saj me përfundimet e 15 Dhjetorit 2016.

Në 2020, Bashkimi Europian ka zhvilluar më tej instrumentin e saj politik të sukseshëm dhe ka fuqizuar strategjikisht Garancinë e të Rinjve. Tani përfshin të rinjtë e grupmoshës 25-29 dhe të rinjtë më të pafavorizuar që jetojnë në zona të thella dhe që i përkasin pakicave etnike.

Ndërtohet në 4 faza të ndërhyrjes politike dhe 3 mundësues ndërsektorial. Bazuar në këtë strukturë të përbashkët, skema është organizuar në përputhje me rrethanat kombëtare, rajonale dhe lokale, duke i kushtuar vëmendje gjinisë dhe diversitetit të të rinjve.

Katër fazat e ndërhyrjes së politikave të Garancisë së të Rinjve e rishikuar sipas rekomandimit të Këshillit të 30 Tetorit 2020 janë si në vazhdim:

- ▷ **Faza 1: Hartimi dhe ndërhyrja e hershme**
Garancia e të Rinjve duhet të hartohet dhe të zbatohet bashkërisht në partneritet mes institucioneve qeveritare në nivel qendror, rajonal dhe lokal, sektorit privat, sektorit të biznesit, institucioneve të arsimit dhe trajnimit, OJF-ve dhe shoqatat e të rinjve, duke pasur parasysh natyrën ndër-sektoriale të politikave të punësimit të të rinjve.
- ▷ **Faza 2: Shtrirja** deri të NEETs e parregjistruara-që përfshin hartimin e programeve të shtrirjes për NEETs e vështira për t'u arritur, duke identifikuar mënyrat më të mira për të përfshirë partneritetet ndërmjet shërbimeve sociale, shërbimeve të punësimit, grupeve të komunitetit dhe OJQ-të e të rinjve për të arritur te grupet NEET të marginalizuara.

- ▷ **Faza 3: Përgatitja** – masat e reja të aktivizimit; Masat parandaluese për të trajtuar largimin e hershëm nga arsimi dhe trajnimi nga personat në nevojë; forcimi i masave ekzistuese dhe masa me intensive të politikës aktive të punësimit për të rinjtë me më pak avantazhe siç janë NEETs me nivel arsimi të ulët dhe të mesëm.
- ▷ **Faza 4: Oferta** – integrimi i tregut të punës përmes dhënies së ofertave cilësore të rinjve.


Përdorimi efektiv i mundësuesve të mëposhtëm ndërsektorial si çelës për zbatimin e suksesshëm të skemës dhe arritjen e ofrimit të ofertave cilësore për të gjithë të rinjtë.

- Mobilizimi i Partneriteteve: Fuqizimi i partneriteteve ndërmjet qeverisë, ofruesve dhe aktorëve të interesuar duke përfshirë punëdhënësit, institucionet e arsimit dhe të trajnimit, partnerët socialë, shërbimet e punës së të rinjve, organizatat rinore, OSHC; promovimi i protokolleve për bashkëpunim, p.sh. one-stop-shops.
- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe monitorimi: Forcimi i sistemeve për të monitoruar integrimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të tregut të punës; inkurajimin e ndarjes së hulumtimit, profilizimit dhe ndjekjes së të dhënave ndërmjet partnerëve Garancisë së të Rinjve, duke respektuar rregullat e mbrojtjes së të dhënave.
- Përdorim i plotë dhe optimal i fondeve: Dedikimi i burimeve të përshtatshme kombëtare për zbatimin e masave të politikës; përdorim i plotë dhe optimal i instrumenteve aktuale të dhe burimeve të tjera financuese të Bashkimit Europian të disponueshme për Shtetet Anëtare.

Garancia e të Rinjve në Bashkimin European

Plani Ekonomik dhe i Investimeve (EIP) për Ballkanin Perëndimor, i publikuar nga Komisioni European (EC) në Tetor të 2020, propozon zbatimin e skemave të Garancisë së të Rinjve në Ballkanin Perëndimor në katër faza përgjatë periudhës 2021-27. Fazat e ndryshme përshkruhen më poshtë:

Shenja 10 e EIP për Ballkanin Perëndimor



- ▷ **Faza 1: Planet e zbatimit të Garancisë së të Rinjve**
- ▷ **Faza 2: Puna përgatitore** -- rritja e kapaciteteve të palëve të interesit dhe autoriteteve, burimet në dispozicion, mekanizmat dhe sistemet e përmirësuara, studimet teknike dhe të fizibilitetit
- ▷ **Faza 3: Faza Pilot** -- për të testuar masat që janë planifikuar në marrjen e re të NEETs të cilat janë identifikuar përmes programit të shtrirjes në një numër të selektuar të zonave të autoritetit lokal.
- ▷ **Faza 4: Përhapja në zbatim të plotë** – bazuar në vlerësimin e fazës pilot, duhet të bëhen modifikime për planin e Garancisë së të Rinjve dhe të fillojë me zbatimin e tij të plotë.

Faza 1 do të fillojë sapo WB6 do të angazhohet për të ngritur task-forcat ndër-ministrorë ku përfshihen palët relevante të interesit për të hartuar Planet e Implementimit të Garancisë së të Rinjve (YGIPS), që janë një bazë kryesore për zbatimin e Garancisë Rinore.

Përpara zbatimit të Fazave 1-4 2021-27, një Fazë 0 shërben për të rritur ndërgjegjësimin dhe marrëveshjen politike sidomos përmes takimeve rajonale dhe bilaterale të nivelit teknik. Në takimin ministror të 8 Korrikut 2021, ministrat e punësimit dhe çështjeve sociale të WB6 kanë miratuar Garancinë Rinore për BP.

Harta të detajuara të rrugës individuale të 6 shteteve të Ballkanit Perëndimor në lidhje me programet e punësimit të të rinjve dhe Garancisë së të Rinjve sipas modelit të Garancisë së të Rinjve të BE-së, janë dhënë në Studimin ESAP2 mbi Punësimin e të Rinjve të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (www.esap.online)

Ndërsa këto udhërrëfyes individualë janë inpute të rëndësishme analitike, ato nuk mund të zëvendësojnë ose të paragjykojnë ekonomitë individuale të Planeve të Zbatimit të Garancisë së të Rinjve.

Garancia e të Rinjve në Ballkanin Perëndimor –Mbështetja e BE-së

- [Plani Ekonomik dhe i Investimeve i BE-së për Ballkanin Perëndimor, i cili gjithashtu i referohet IPA III](#)

Rekomandimet e politikave të punësimit për të rinjtë

Përmirësimi i Politikave Aktive të Tregut të Punës (ALMPs)

- ▷ ofrimi i alokimeve më të mëdha financiare për ALMPs
- ▷ Sigurimi i këshilluesve për karrierën dhe shërbimeve të këshillimit për kërkimin e punës përmes organizatave të ofruesve të pavarur
- ▷ Sigurimi i këshillimit dhe mentorimit për bizneset e reja, grantet për bizneset e reja dhe kreditë që synojnë personat me arsim të lartë në partneritet me institucionet financiare dhe agjencitë Europiane
- ▷ Sigurimi i subvencioneve për NVM që punësojnë kursantë të rinj ose studentë
- ▷ Përmirësimi i shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijëve dhe përfitimeve prindërore për nënat e reja që kthehen në punë

Përmirësimi i trajnimit dhe rikualifikimit Programet

- ▷ Intensifikimi i programeve për aftësim profesional. Mbështetje për institucionet e edukimit dhe të trajnimit për të ofruar kurse dhe trajnime praktike
- ▷ Ofrimi i kurseve të trajnimit afat-shkurtër për të diplomuarit nga shkollat VET në partneritet me punëdhënësit dhe me qendrat e formimit profesional
- ▷ Inkurajimi i shkollave dhe bizneseve private për të bashkëpunuar dhe për të ofruar trajnime dhe kurse
- ▷ Ofrimi i masave të fokusuar për të rinjtë nga familjet në nevojë dhe minoritetet etnike
- ▷ Rritja e ndërgjegjësimit të të rinjve përmes rrjeteve sociale në lidhje me mundësitë e disponueshme për NEETs për t'u angazhuar në edukim ose në trajnime

Përmirësimi i Kapaciteteve PES

- ▷ Sigurimi i kapacitetit të duhur të stafit dhe emërimi i punonjësve të dedikuar terreni për të rinjtë
- ▷ Zhvillimi i rasteve të menaxhimit të integruar, të individualizuar për të rinjtë e papunë
- ▷ Kryerja e studimeve të specializuara për të rinjtë e marginalizuar për të hartëzuar popullatën NEET
- ▷ Vendosja e njësive lëvizëse PES për të kontaktuar NEETs
- ▷ Sigurimi i këshillimit individual (një me një) dhe përmirësimi i programeve të trajnimit për të rinjtë e NEETs
- ▷ Hartimi i programeve të synuara për grup-mosha të ndryshme NEET

Përmirësimi i koordinimit të palëve kombëtare të interesit

- ▷ Zhvillimi i koordinimit efektiv dhe partneritetit në të gjitha fushat e politikave duke përfshirë punësimin, arsimin, rininë, barazinë gjinore dhe çështjet sociale
- ▷ Inkurajimi dhe mbështetja e partneriteteve që punojnë ndërmjet CWS dhe PES dhe potencialit për krijimin e one-stop shops për të rinjtë
- ▷ Mbështetja e bashkëpunimit ndërmjet PES dhe Organizatave për të Rinjtë për të siguruar informacion për NEET e parregjistruar
- ▷ Kujdesi për shkëmbimin e informacionit në të gjitha nivelet e qeverisë dhe fushat e politikave (punësimi, arsimi, strehimi dhe shëndeti)
- ▷ Ndërtimi i rrjeteve të praktikave ndërmjet aktorëve relevantë (agjencitë qeveritare, agjencitë publike, organizatat e të rinjve, shoqatat e biznesit, institucionet e arsimit, shoqatat e strehimit, shoqatat e siguruesve të shëndetit)



good.better.regional.

Brought to you by the RCC's
Employment & Social Affairs Platform 2 Project
#ESAP2
www.esap.online

Follow us on:



@rccint



RegionalCooperationCouncil




RCCSec



regionalcooperationcouncil_rcc



Regional Cooperation Council



RegionalCooperationCouncil



This project is funded
by the European Union

ALB-Shumica e përmbajtjes, me leje, është përdorur nga materialet e informacionit të Komisionit Europian mbi Garancinë e të Rinjve. Përmbajtja e mbetur buron nga Studimi i porositur i RCC Për Punësimin e të Rinjve në Ballkanin Perëndimor dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (KBR) dhe Bashkimit Europian (BE)